



RAPORT

MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2018

Mars 2019

RAPORT
MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË
TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT
NË SHQIPËRI PËR VITIN 2018

Tiranë, Mars 2019

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit *“Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII”*, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së MBRETËRISË SUEDEZE.



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders

Përgatitën:

1. Rovena Vuksani, Juriste/Asistente Projektsh pranë KSHH-së
2. Ardita Kolmarku, Juriste/Asistente Projektsh pranë KSHH-së
3. Alketa Vushaj, juriste pranë KSHH-së

Rishikuan:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor pranë KSHH-së
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KSHH-së

Përktheu:

Anri Pashaj

Design: Dafina Stojko

Shtypur: Classic Print

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Të dashur lexues,

Gjatë vitit 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij ka vazhduar punën në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në vendin tonë. Për realizimin e këtij misioni, KShH është mbështetur në legjislacionin e brendshëm, në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në dokumentet ndërkombëtare ku vendi tonë ka aderuar si dhe në praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Jemi të ndërgjegjshëm se në fushën e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të shtetasve me gjithë rezultatet e arritura, ngelet shumë për të bërë. Integrimi evropian i vendit tonë kushtëzohet nga shumë faktorë. Detyrë parësore ngelet zbatimi në praktikë i reformës në Drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Kjo e bën të nevojshme që gjatë vitit 2019, KShH të vijojë të kryejë monitorime në këto fusha edhe për faktin sepse janë edhe kushte për çeljen e bisedimeve me Bashkimin Evropian.

Gjatë vitit 2018, vëmendja kryesore e KShH-së ka qenë ecuria e zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, në mënyrë të veçantë për procesin e Vettingut (rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve). KShH ka zbatuar dhe vazhdon të zbatojë nisma të rëndësishme duke përdorur si formë kryesore monitorimin, verifikimin në vend të situatës të respektimit të të drejtave të njeriut dhe reagimin publik. Në metodologjinë e tij, KShH i ka kushtuar rëndësi të veçantë sensibilizimit të shtetasve për njohjen e dispozitave të ndryshme ligjore ku sanksionohen të drejtat e tyre.

KShH në veprimtarinë e tij, nuk është kufizuar vetëm në konstatime, por ka reaguar për rivendosjen e ligjit të shkelur si dhe për zgjidhjen e drejtë të ankesave të qytetarëve. Në raportet, informacionet dhe reagimet tona publike, krahas evidentimit të shkeljeve, KShH ka bërë rekomandime dhe sugjerime konkrete si për përmirësime të mëtejshme në legjislacion edhe për marrjen e masave më të efektshme në luftën kundër korrupsionit dhe papërgjegjshmërisë të disa organeve shtetërore. Ndërkohë që në raste të shkeljeve flagrante apo cenimit të të drejtave të grupeve të pambrojtura të shoqërisë, KShH ka ndjekur në gjykatat vendase dhe në Gjykatat e Strasburgut disa procese gjyqësore, një pjesë e të cilave ka rezultuar e suksesshme.

Në fokus të veçantë të këtij raporti është edhe liria e medias në Shqipëri.

Në sajë të disa artikujve të punuar nga gazetarë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut, KShH sjell këndvështrime dhe opinione profesionale për problematikat dhe sfidat me të cilat ndeshet sot shtylla më e rëndësishme e një demokracie të lirë, Media.

Në përfundim dëshirojmë të falënderojmë për kontributin me përkushtim dhe profesionalizëm të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe stafit ekzekutiv të KShH-së, aktivistëve, vëzhguesve, korrespondentëve, bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm të KShH-së, organizatave tona simotra në Serbi, Hollandë, Greqi dhe Norvegji.

Dëshirojmë të falënderojmë ato institucione shtetërore që janë treguar të hapura, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme në shkëmbimin e korrespondencave dhe takimet advokuese për të adresuar dhe përmirësuar respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Një falënderim i veçantë shkon për organizmat vendas dhe ndërkombëtare që kanë bërë të mundur mbështetjen financiare të veprimtarisë tonë, përkatësisht të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasada Suedeze, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, Ambasada Britanike, Komisioni Europian, Save the Children, European Roma Rights Center, etj.

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

PËRMBAJTJA

SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT GJATË VITIT 2018	6
1. Reforma në Drejtësi	6
2. Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve nga strukturat e policisë	7
3. E drejta e jetës dhe shëndetit	7
4. Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve në pikat e kalim e kufirit	8
5. Të drejtat e personave me liri të kufizuar	8
6. E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur	11
7. Korrupsioni në Arsimin e Lartë	11
8. Lufta ndaj ekstremizmit të dhunshëm, barazia dhe ndalimi i diskriminimit	11
9. E drejta e pronës	12
10. Lobim dhe Advokim	12
11. Shërbimi ligjor falas	13
12. Liria e shprehjes dhe sfidat me të cilat përballen gazetarët shqiptarë	13
12.1 PIRATERIA DHE SHPIFJA MEDIATIKE, NGA Z. KUJTIM ÇASHKU, AKTIVIST I TË DREJTAVE TË NJERIUT, THEMELUES I KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT	14
12.2 MEDIAT ONLINE NËN SULM: NISMAT LIGJORE DHE RETORIKA POLITIKE, NGA ZNJ. KRISTINA VOKO, DREJTORE EKZEKUTIVE BIRN (BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK).....	16
12.3 MEDIA, JO VETËM MISION INFORMUES POR EDHE KULTUROR Z. DENIS DYRNJAJA, GAZETAR	20
12.4 TË DREJTAT E GAZETARËVE NË PUNË, ZNJ. DAFINA HYSA, GAZETARE....	22
12.5 A MUND TË KONTROLLOHET MEDIA (VETËM) NGA LIGJI? - ZNJ. KAROLINA RISTO, GAZETARE	26
12.6 A LIDHET LIRIA E SHPREHJES ME SHKEJLET E KODIT TË ETIKËS? - Z. KOLORETO ÇUKALI, GAZETAR	30

SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT GJATË VITIT 2018

Gjatë vitit 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka fokusuar veprimtarinë e tij në fusha të rëndësishme si zbatimi i reformës në drejtësi, aksesit në drejtësi i grupeve në nevojë, respektimi i të drejtave të njeriut në institucionet penitenciare, komisariatet e policisë, spitalet psikiatrike, pikat e kalim kufirit dhe qendrat e azilkërkuësve, parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe diskriminimit, promovimi i medias së lirë, transparenca dhe mirëqeverisja e institucioneve, mbrojtja e mjedisit, etj.

KShH ka realizuar monitorime të herëpashershme, ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor, ka reaguar publikisht për rastet e shkeljeve flagrante të të drejtave të shtetasve, ka kërkuar informacion nga disa institucione shtetërore. Nga rezultatet e monitorimeve dhe verifikimeve të veçanta ka paraqitur rekomandime dhe sugjerime për rivendosjen e ligjit të cënuar dhe përmirësimin e gjendjes., ka ofruar shërbime ligjore falas për grupet në nevojë, si dhe ka përfaqësuar çështje me interes publik në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

1. Reforma në Drejtësi

Procesi i vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe pse u shoqërua me disa vonesa, ka ngjallur interes të lartë tek publiku. Shtetasit kanë përcjellë një numër të konsiderueshëm ankesash tek organet e vettingut, por në asnjë rast nuk del që ata të kenë kërkuar statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Vettingu ka dhënë rezultatet e para konkrete. Gjatë monitorimit të seancave dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit u konstatua se në tërësi, procesi ka qenë publik, transparent dhe është respektuar procesi i rregullt ligjor. Megjithatë, vëzhguesit e KShH-së kanë evidentuar raste sporadike të standardeve të dyfishta në vendimmarrjen e KPK-së, ndaj kemi mendimin se praktika e vettingut ka nevojë të konsolidohet. Procesi i rivlerësimit është bazuar në shumicën e rasteve në kriterin e pasurisë, duke mos pasur në konsideratë edhe dy kriteret e tjera: atë të vlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale.

Vonesat në zbatimin e ligjit të vettingut, vonesat në ngritjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) kanë krijuar ngërçe dhe probleme shqetësuese në drejtim të aksesit të qytetarëve në drejtësi, dhe në shqyrtimin e çështjeve të grumbulluara në këto gjykata veçanërisht në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.

Disa nga arsyet që kanë penguar konstituimin me legjitimitet të plotë vendimmarrës të KED-së kanë qenë ritmet jo dinamike të vettingut me përparësi të anëtarëve të shortuar në KED, mos kalimi me sukses i vettingut për pjesën dërrmuese

të këtyre kandidatëve apo dorëheqja e tyre si dhe vështirësitë e paraqitura në drejtim të gjetjes së kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj. Të njëjtët faktorë kryesisht kanë ndikuar edhe në vonesat për zgjedhjen e anëtarëve magjistratë në dy Këshillat (KLGJ dhe KLP). Megjithatë, ngërçi në këto dy Këshilla u zhblllokua pas realizimit të mbledhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat u karakterizuan nga një proces i hapur, publik dhe transparent. Megjithatë, kemi mendimin se platformat e kandidatëve magjistratë në këto Këshilla, në disa raste nuk ishin vizionare. Në vendimmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve për disa nga kandidatët magjistratë u vërejtën elementë të korporatizmit. Vëzhguesit e KShH-së vërejtën se në disa raste u zgjodhën ata kandidatë që nuk ruajtën një balancë të drejtë në platformat e prezantuara, sa i takon forcimit të pavarësisë së gjyqësorit nga njëra anë si dhe dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor nga ana tjetër.

Disa nga ligjet e Reformës në Drejtësi janë bërë objekt rishqyrtimi në Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë, në tre vendime ka shfuqizuar si të papajftueshëm me Kushtetutën të disa prej dispozitave të dy ligjeve të atakuara, por deri më sot rezultoi se Kuvendi nuk i ka marrë ato në shqyrtim.

2. Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve nga strukturat e policisë

Gjatë periudhës Shkurt - Qershor 2018, KShH monitoroi 28 komisariate të policisë në rang vendi. Pavarësisht investimeve në infrastrukturë, kushtet e akomodimit të shtetasve të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë në disa prej këtyre komisariateve janë krejt të papërshtatshme dhe në disa raste kanë elementë të trajtimit ç'njerëzor (mungesa e higjienës, krevateve, ndriçimit natyral apo artificial, mungesa e ajrimit, etj.). KShH ka monitoruar 2 ankesa për ushtrim dhune nga forcat e policisë. Në këtë drejtim ka pasur edhe pretendime të tjera për ushtrim dhune, por ato kanë qenë të vonuara dhe si pasojë vërtetimi i tyre ka qenë i vështirë. Mungesa e mjekut apo e kontrollit mjekësor, mungesa e kamerave gjatë intervistimit (e cila nuk parashikohet as në legjislacionin tonë të brendshëm) apo pretendimet se ushtrimi i dhunës është realizuar gjatë transferimit për në Komisarjat ose nga Komisarjati në Burg, kanë sjellë vështirësi për të provuar pretendimet e personave. Në disa prej këtyre rasteve, sikurse ishte edhe ai i ankesave të familjarëve të të ndjerit Enea Ftoi që humbi jetën në ambientet e policisë, KShH ka kërkuar që prokuroria të forcojë hetimin e plotë, objektiv dhe të gjithanshëm.

3. E drejta e jetës dhe shëndetit

KShH ka ndërmarrë 13 misione monitorimi në spitale psikiatrike dhe në burgje në rang vendi, për respektimin e të drejtave të shtetasve me probleme të shëndetit mendor. Përsa i përket sigurisë në rastet e personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, stafi mjekësor dhe psiko-social rezultoi se nuk ndërmerr hapat e duhur për të vlerësuar në mënyrë periodike rrezikun e sigurisë nga vetëlëndimet

e këtyre shtetasve. Në sistemin e burgjeve, u vërejtën mungesa për staf mjekësor dhe psiko-social të specializuar për këta të sëmurë si dhe parregullsi në plotësimin e kartelave klinike. Akomodimi i shtetasve me masë mjekësore në sistemin e burgjeve mbetet një fenomen shqetësues. Në spitalet psikiatrike problematik paraqitet fenomeni i braktisjes nga ana e familjarëve të pacientëve kronikë dhe subakutë të akomoduar në shërbimet psikiatrike. Mungesat në personelin shëndetësor i përkasin kryesisht stafit infermier të mesëm. Mungesa e ambienteve të jashtme në natyrë ka ndikuar negativisht në rehabilitimin e të sëmurëve. Gjithashtu janë konstatuar një sërë parregullsish në procedurat e ndjekura për dokumentimin e rasteve të vendosjes së pacientit në trajtim të pavullnetshëm dhe mungesë e respektimit të standardeve të kufizimit fizik.

4. Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve në pikat e kalim kufirit

Nga monitorimi që KShH ka realizuar në pikat e kalimit kufirit, është evidentuar një rritje e ndjeshme e fluksit të azilkerkuesve dhe migrantëve të paligjshëm krahasuar me vitin e kaluar. KShH ka konstatuar mungesën e kapaciteteve infrastrukturore dhe në burime njerëzore për trajtimin e këtij fluksi të shtuar. Urdhri nr. 805, dt. 01.08.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë ka ndikuar në forcimin e sistemit të menaxhimit të kufijve nëpërmjet kontrolleve rigoroze në kufi, por lind nevoja që ky urdhër të konceptohet dhe të zbatohet nën frymën e detyrimeve konventore që parashikojnë respektimin e lirisë së lëvizjes. KShH vlerëson përpjekjet e autoriteteve për hartimin e Strategjisë Kombëtare për qeverisjen e migracionit dhe Planin e Veprimit 2019 – 2022.


5. Të drejtat e personave me liri të kufizuar

KShH ka kryer rreth 26 misione verifikimi ankesash në sistemin e burgjeve, në gjykatë dhe në terren. Në sistemin penitenciar problematik vijon të jetë mbipopullimi, i cili, në disa raste, është bërë shkak për vendosjen e të paraburgosurve dhe të dënuarve në dhomat e veçimit. KShH ka vërejtur gjithashtu mungesa në personelin mjekësor dhe në medikamente. Programeve edukuese dhe rehabilituese nuk u kushtohet vëmendja e duhur. Pengesë në këtë drejtim është edhe infrastruktura e papërshtatshme e disa institucioneve dhe numri i kufizuar i punonjësve social dhe psikologëve. Në disa raste, personat e privuar nga liria në burgje kanë pretenduar raste të korrupsionit pasiv nga personeli i burgjeve, lidhur me përfitimet nga praktikat e lejeve shpërblyese, transferimet, praktikat e uljes së dënimit si dhe njohjes së kohës së punës në institucion, etj. Hyrja në fuqi e Kodit të Ri të Drejtësisë Penale për të Mitur ka ndikuar pozitivisht në uljen e numrit të të miturve të akomoduar në sistemin penitenciar.

KShH ka trajtuar 3 ankesa nga të dënuarit, të cilët kanë pretenduar se janë dhunuar fizikisht nga stafi me uniformë i burgjeve. Nga komunikimi që kemi patur me

organin e prokurorisë si dhe vendimet që ky organ na ka vendosur në dispozicion për mosfillimin e hetimeve apo pushimin e procesit penal, KShH ka vërejtur se ankesat për ushtrim dhune ndaj të dënuarve nuk hetohen gjithmonë në mënyrë të plotë dhe objektive. Ndërkohë, infrastruktura e institucioneve penitenciare por edhe vetë personeli i burgjeve nuk mundëson një dokumentim të mirë të pretendimeve për ushtrim dhune (p.sh. mungesa e kamerave të sigurisë apo kapaciteti i ulët i tyre, mospasqyrimi në kartelën mjekësore i pretendimeve të personave të dhunuar si dhe shenjave të konstatuara nga mjeku, etj). Këto vepra nuk kualifikohen sipas nenit 86 të Kodit Penal “Torturë apo trajtim c’njerezor” por kualifikohen si plagosje e lehtë, apo veprime arbitrare, çka e lehtëson së tepërmi pozitën ligjore të personave të akuzuar në radhët e personelit, për ushtrim të dhunës.

Gjatë vitit 2018, KShH ka reaguar publikisht në 39 raste për ankesat e verifikuara në institucionet penitenciare dhe ato të policisë, për çështje të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, të jetës dhe shëndetit të shtetasve, për kushtet infrastrukturore tepër të këqija në Komisariate dhe Burgje, etj. KShH ka trajtuar dhe ka ofruar shërbime ligjore për 242 ankesa të përcjella nga qytetarët. Rreth 71 % e ankesave janë të personave të privuar nga liria, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me konflikte të pronësisë, dhunës në familje, marrëdhënieve të punës si dhe ankesa ndaj sistemit të drejtësisë. Nga shqyrtimi i ankesave si dhe për zgjidhjen e drejtë të tyre, KShH i është drejtuar institucioneve përkatëse me rekomandime për të rivendosur të drejtën e cënuar ose për të marrë masat për një trajtim më të shpejtë dhe në përputhje me ligjin të ankesave të shqyrtuara.



Ankesat sipas kategorive dhe nënkategorive janë të paraqitura si më poshtë:

Marrdhëniet e Punës

- Ankesë lidhur me diskriminimin në punë **(2 raste)**
- Ankesë për lëvizje të padrejtë nga puna **(1 rast)**
- Ankesë për veprime arbitrare ngas punëdhënësi **(4 raste)**

Policia

- Ankesa për ushtrim dhunë fizike / psikike nga organet e policisë **(2 raste)**
- Mosmarrja e kallzimit nga organet e policisë **(2 raste)**
- Veprime të padrejta nga organet e policisë **(2 raste)**
- Të tjera **(3 raste)**

Prokuroria

- Shkelje procedurale të procesit të hetimit **(13 raste)**
- Mospranim i kallzimit **(3 raste)**
- Veprime të padrejta dhe arbitrare nga Prokuroria **(7 raste)**

Burg / Paraburgim


- Dhunë (fizike apo psikologjike) e ushtruar në burg nga personeli / të dënuar të tjerë **(8 raste)**
- Kushte të këqija në paraburgim dhe burgje **(12 raste)**
- Mosdhënie e shërbimit shëndetësor dhe kujdesi social në burg **(15 raste)**
- Mosdhënie përgjigje për ankes kërkesat e të dënuarve nga institucionet **(5 raste)**
- Shkelja e të drejtave në paraburgim / burgje **(40 raste)**
- Mungesë informacioni nga administrata e burgjeve për amnistinë **(7 raste)**
- Transferim / mostransferim në një institucion tjetër / brenda të njëjtit institucion **(18 raste)**
- Të tjera **(13 raste)**

Civile të ndryshme

- Ankesa në lidhje me konfliktet e pronësisë **(5 raste)**
- Ankesa që lidhen me dhunën në familje / zgjidhje martesë / regjistrimin e fëmijëve **(3 raste)**
- Kerkesë për ndihmë ekonomike / pensionet **(1 rast)**
- Të tjera **(10 raste)**

Gjyqësori

- Mungesë dhënie së informacionit nga Gjykatat **(5 raste)**
- Procesi i parregullt gjyqësor **(12 raste)**
- Vendime të padrejta gjyqësore / pretendim për pafajësi **(16 raste)**
- Shkelje procedura gjatë gjykimit dhe zvarritje të procesit gjyqësor **(6 raste)**
- Të tjera **(4 raste)**



6. E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur

KShH ka ndjekur me vëmendje procesin e reformës zgjedhore, kryesisht në drejtim të adresimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Ngritja e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore nuk mundësoi arritjen e konsensusit të nevojshëm midis partive politike, për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ndërkohë që në Qershor të vitit tjetër do të zhvillohen zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Reforma zgjedhore, vijon të mbetet peng i monopolit të partive politike.

7. Korrupsioni në Arsimin e Lartë

Niveli i korrupsionit mbetet i lartë dhe faktet e kohëve të fundit tregojnë se edhe në sektorin e arsimit aktet korruptive nuk kanë munguar. Në forumet e organizuara nga KShH me studentë të Universiteteve janë evidentuar forma të ndryshme të shfaqjes së korrupsionit.

8. Lufta ndaj ekstremizmit të dhunshëm, barazia dhe ndalimi i diskriminimit

Gjatë këtij viti KShH është angazhuar edhe me organizimin e takimeve ndërgjegjësuese me të rinj dhe përfaqësues të shoqërisë civile për rrezikun që paraqet fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Nga veprimtaritë e zhvilluara

në bazë, evidentohen një sërë problematikash në drejtim të njohjes relativisht të pakët të këtyre fenomeneve, ekzistencës së riskut potencial për radikalizimin e grupeve në nevojë, prezencës së sjelljeve të bullizmit në shkolla, rrezikut që vjen nga përdorimi i shtuar i medias sociale, i cili mund të përbëjë burim të rrezikshëm rekrutimi të të rinjve sidomos atyre të vetmuar, etj.

9. E drejta e pronës

KShH ka trajtuar dhe po monitoron çështje të strehimit dhe pronësisë të adresuara nga ankesat e qytetarëve. Nga trajtimi i tyre është vërejtur mosrespektimi i afateve ligjore të njoftimit për prishjen e banesave nga ana e IKMT-së, si dhe mungesa e alternativave të qëndrueshme të strehimit për njerëzit në nevojë. KShH ka reaguar publikisht për protestën e banorëve të Unazës së Re, duke i bërë thirrje autoriteteve për të dialoguar në mënyrë konstruktive në gjetjen e një zgjidhje adekuate dhe konform standardeve të vendosura nga Gjykata e Strasburgut, si detyrime minimale që shtetet kanë për të zbatuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Rasti *Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar* është precedenti mbizotërues në praktikën e kësaj gjykate për problemet e ngrehinave pa leje, ku është analizuar sistemi i kufizime të së drejtës për banesë. Kjo e drejtë mbron jo vetëm ndërtimet pa leje, por edhe ngrehinat prej plastmase dhe ato lëvizëse të Minoritetit Rom dhe Egjiptian, çka e ka zgjeruar fushën e mbrojtjes së nenit 8 të Konventës Evropiane që mbron të drejtën për jetë familjare¹.

10. Lobim dhe Advokim

KShH gjithashtu ka dhënë kontribut modest dhe të orientuar drejt përmirësimit të akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore që janë hartuar gjatë vitit 2018. Konkretisht janë ofruar opinionenca ligjore për 12 akte të ndryshme, ndër të cilat për strehimin social, organizimin e lojërave të fatit, për profesionin e lirë të avokatit, aktet nënligjore për ndihmën juridike të garantuar nga shteti etj.

1 GJEDNJ ka marrë në shqyrtim çështjen e humbjes së menjëhershme të banesës, në rastet e vendlindjeve për ti prishur ato për shkak se janë pa leje dhe në shkelje të legjislacionit që rregullon ndërtimin e banesave (Ivanova dhe Cherkezov k. Bullgarisë). GJEDNJ shqyrtoi kryesisht nëse prishja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Në shqyrtimin e çështjes Gjykata u mbështet në vendimet e mëparshme, në të cilat është konstatuar se procedurat për të dëbuar nga shtëpia duhet të pajtohen me interesin që mbrohet nga neni 8 i Konventës; humbja e shtëpisë është një nga format më ekstreme të ndërhyrjes në të drejtën për të respektuar banesën, pavarësisht nga fakti nëse personi që jeton në banesë i përket ose jo një grupi vulnerabël. Në vlerësimin nëse kishte patur ose jo shkelje të nenit 8 në këtë rast, Gjykata e bazoi vlerësimin në konkluzionin se çështja në fjalë ishte shqyrtuar nga gjykatat vendase vetëm mbi bazën e paligjshmërisë së ndërtimit dhe gjykimi ishte kufizuar vetëm në këtë aspekt, pa marrë në vlerësim efektin disproporcional potencial të zbatimit të një urdhëri prishje në situatën personale të aplikantëve. (Ibid., §§ 49-62)

11. Shërbimi ligjor falas

Gjatë vitit 2018, KShH ka vënë në lëvizje me nismën e saj ose ka përfaqësuar disa shtetas për çështje me interes publik para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykatave vendase, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut. Vlen të përmendim këtu raste të tilla si, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm i banorëve të Minoritetit Rom në një lagje të Fushë Krujës, akomodimi në sistemin e burgjeve i shtetasve me masë mjekësore të dhënë nga gjykata, sigurimi dhe vendosja e implantit koklear të të miturit, mungesa e shpërblimit adekuat ndaj punës së të dënuarve, ndotjet e shkaktuara nga furrat gëlqerore në Fushë-Krujë, ndotjet në lumin Gjanicë, Tërkuzë, Devoll, etj. Disa prej këtyre çështjeve janë zgjidhur me sukses, duke krijuar modele pozitive të mbrojtjes gjyqësore. Aktualisht, pranë Gjykatës së Strasburgut janë në shqyrtim edhe 5 çështje të dërguara nga shtetas të përfaqësuar nga KShH, gjatë viteve 2016-2017.

12. Liria e shprehjes dhe sfidat me të cilat përballen gazetarët shqiptarë

Në kuadrin e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, KShH ka reaguar publikisht edhe në rastet e presionit apo kërcënimeve që u janë bërë gazetarëve lidhur me ushtrimin e detyrës së tyre, ku më i rëndi ishte ai ndaj banesës së familjarëve të gazetares Klodiana Lala. Në disa raste cënimi i lirisë së shprehjes është minimizuar pas presioneve, kërcënimeve dhe ndërhyrjeve në ushtrimin e profesionit të lirë të gazetarit, ndërkohë që këto raste, në përfundim të hetimeve nuk rezultojnë të ndëshkohen penalisht autorët e tyre apo të vërtetohet nëse goditja është bërë për shkak të detyrës së gazetarit. Në këtë drejtim, vlen të rishikohen edhe dispozitat e Kodit Penal, të cilat nuk parashikojnë mbrojtje të posaçme penale për gazetarët, kur vepra penale kryhet për shkak të ushtrimit të profesionit nga gazetari.

Liria e tubimit në mënyrë paqësore është një e drejtë kushtetuese dhe e parashikuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Dialogu real dhe jo formal me protestuesit është detyrim që çdo institucion ka në përmbushje të parimit të qeverisjes së hapur. Në disa raste, përdorimi i fjalëve ofenduese ndaj protestuesve apo politizimi i protestave ka ndikuar në përshkallëzimin e tyre, duke u shoqëruar me lëndime në radhët e forcave të rendit dhe protestuesve. Në disa tubime, sipas medias ka pasur raste të fillimit të procedimit penal ndaj protestuesve për kundërvajtjen penale të “Organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”. Kemi mendimin se ligjit për tubimet dhe Kodi Penal vlen të rishikohet në dritën e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, e cila, në praktikën e saj ka vërejtur forma të ndryshme të ndërhyrjes së shtetit në të drejtën për tu organizuar në mënyrë paqësore (si p.sh. “a” refuzimi i autoriteteve për të lejuar tubimin, “b” shpërndarja e tubimit, “c” evakuimi i protestuesve nga vendi i tubimit, “d” ndalimet dhe sanksionet pas tubimit, si në aspektin administrativ dhe atë penal).

12.1 PIRATERIA DHE SHPIFJA MEDIATIKE, NGA Z. KUJTIM ÇASHKU, AKTIVISTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT, THEMELUES I KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

Pirateria dhe shpifja mund të konsiderohet sot, si një degradim shpirtëror e mendor i njeriut. Neil Postman në “ Amusing Ourselves to death” thotë se ka dy mënyra me të cilën rrënohet shpirti kulturor i njeriut: ai violent Orwellian i burgosjes së lirisë dhe ai, jo violente Huxleyan burlesk i shpërbërjes së lirisë në kaos.

Në thelbin e vet qoftë njëra apo tjetra formë e degradimit mendor e shpirtëror, përbën një shkelje të lirisë së shprehjes dhe integritetit e reputacionit të njeriut.

Mediat tona në tërësi, përfshirë dhe ato on-line, mbeten ende të virusuara nga këto dy fenomene, si ai violent nga gjuha dhe vokabulari i përdorur dhe ai jo violente nga pirateritë “argëtuese”.

Vendi ynë, në diktaturë burgosi fjalën e lirë, ndërkohë në post diktaturë po shohim se si fjala ka humbur vlerën dhe kuptimin e saj në mënyrë burleske duke krijuar një deziluzion të lirisë në shoqëri. D.m.th. sot mund të thuash gjithçka e nuk ndodh asgjë.

Dikush i thotë tjetrit hajdut e kriminel dhe tjetri bën të njëjtën ndaj tij, madje dhe në parlament, dhe si rrjedhojë fjala hajdut e kriminel ka humbur kuptimin dhe vlerën e vet, për aq kohë sa ndëshkimi penal mbetet në ajër për këdo.

Faik Konica na thotë se, gjuha (pra fjala) përfaqëson një besnikëri të përkryer , të metodës mendore të një populli, mënyrën e zakonit që ai përcjellë idetë e tij.

Forma e degradimi të mendjes dhe shpirtit, përmes keqpërdorimit apo keqdashjes së një dhune ç’memorizuese, po e bën njeriun indiferent ndaj vlerës që fjala ka. Po e zhyt atë, në deziluzion dhe po i shkatërron atij, besimin tek e drejta, ligji dhe e vërteta.

Në diktaturë, ky degradim kryhej nga propaganda ideologjike, ndërsa sot, në post diktaturë nga mos ndarja dhe degradimi i pushteteve. Pushteti i vetëm që rekruton dhe korrupton pushtetet e tjera, përfshi dhe atë mediatic është pushteti i parasë.

Tek ne, pushteti mediatic ashtu sikurse dhe partitë politike, u krijuan dhe vazhdojnë të mbajnë gjallë vet veten, vetëm në funksion të profiteve financiare që ato nxjerrin nga pushteti i tyre. Media blen politikën dhe politika blen median, duke anashkaluar interesin publik për të cilin ato krijohen.

Metodologjia e arritjes së qëllimeve reduktohet në, banalitet dhe agresivitet, gjuhë urrejtje dhe shpifje, pirateri e korrupsion galopant, dhunë si model force dhe shmangie e çdo përballje me ligjin. Mjafton të kujtojmë se ç’po ndodh me zvarritjen dhe rezistencën aktuale të reformës në drejtësi për ta ilustruar këtë fenomen.

Kjo metodologji është shndërruar në një normalitet, në një zbavitje teatrale si në parlament, në tavolinat centrifugale të mediave dhe në çdo lloj forme e rituali komunikimi të përditshëm publik.

I njëjti fenomen mimetic (copy-paste) është shpërndarë si metodologji jo vetëm në ekzistencës së 68 rrjeteve televizive por dhe në afro 800 portaleve on-line në një vend me 2.8 milion banorë.

Zhvillimi i pakthyesëm i teknologjisë së re, aksesit plotë në internet, pa dyshim që ka zgjeruar hapësirën e lirisë së informacionit, komunikimit dhe formimit për këdo

duke shembur çdo kufi fizik e gjeografik, çdo përplasje kulturore dhe ekzistence shteti nationalist e monopolist në botë. Planeti ynë është bërë më e vogël dhe dija rreth tij gjithnjë e më e madhe.

Por, nga ana tjetër shpejtësia e zhvillimit të teknologjisë ka vënë në pikëpyetje disa vlera thelbësore morale dhe etike të shoqërisë moderne. Është krijuar një lloj ndotje ekologjike kulturore e shpirtërore. Është vënë në pikëpyetje raporti i njeriut, me të drejtën dhe të vërtetën. Njeriu ka humbur besimit tek tjetri, tek ligji, tek institucioni, tek e drejta dhe e vërteta si vlera të qenësishme për të garantuar marrëdhënien humane të tij. Liria e shprehjes është vënë në pikëpyetje.

Pyetjet që shtrohen janë :

- Kë ka matshmëri të saj liria e shprehjes?
- Është ajo e pa kufizueshme?
- A është e njëjta liri shprehje kur mbrojmë një interesit publik në raport me ata që e përdorim lirinë e shprehjes për të fshehur e mbrojtur një interes korruptiv privat ?
- A dëmton shpifja interesin publik, qoftë dhe atëherë kur ajo cënon dinjitetin dhe reputacionin e një individi të caktuar ?
- Cili është mekanizmi i brendshëm, që shërben si vet- rregullator, brenda vetë shoqërisë?
- A është niveli kulturor me vlerat etike e morale që mund të shërbejë si një vet rregullator?
- A është arsimi dhe roli edukativ që ai luan në shoqëri një rregullator që duhet të ri sistemojë vetveten në raport me dinamikën e re të formave të lirisë së shprehjes?
- Kush na mundëson vendosjen e një raporti më të drejtë mes lirisë dhe shpërdorimit të saj ?
- A janë të mjaftueshëm mekanizmat ligjore që ndëshkojnë penalisht çdo lloj shpërdorimi të lirisë qofshin dhe në vendet demokratike?

Aktualisht, nga 28 vendet anëtare të BE, 20 prej tyre e konsiderojnë fyerjen dhe shpifjen si krime penale dhe i ndëshkojnë shkelësit e tyre me heqje lirie. Të tjera vende ndalen tek ndëshkimi i shkelësve me gjoba të rënda.

Natyrisht ndëshkimi penal i shpifjes është një e drejtë e përvokueshme, por jo një zgjidhje, sidomos në shoqëritë ku ka një degradim kulturor e shpirtëror, sikurse është shoqëria jonë post-traumatike.

Nëse mashtrimi dhe shpifja është bërë pjesë e normalitetit të përditshmërisë së komunikimit tonë, atëherë do na duhet të marrim në konsideratë disa elementë të tjerë rregullator brenda vet shoqërisë siç janë etika dhe morali. Pra, disa ligje e kode të pashkruara, që janë pjesë e kushtetutës shpirtërore por që mbajnë gjallë atë që quhet “common sens” dhe që vet vepron si rregullator ekuilibrash në brendësi të shoqërisë.

Neve, po ri-disenjojmë rolin e komunitetit si një shtresëzim vital shoqëror. Pas gati pesë dekadash të kolektivizmit ekstrem dhe tre dekadash të individualizmit ekstrem nevoja e një “common sens” po bëhet prioritare.

Ky “common sens” po i jep peshë tjetër rolit edukues të veprimit komunitar si mekanizëm mbrojtës i interesave publike.

Në sistemin tonë arsimor, po aplikohen platforma elektronike me mbështetjen direkte të politikave të Komisionit European që nxisin këto veprime komunitar.

EPAEL (European Platform for Adult Learning in Europe) me temë “Etika në sistemin arsimor në Shqipëri, po përfshin një spektër të gjerë komunitetesh të arsimit parashkollor, elementar, të përgjithshëm dhe të lartë.

Ekologjia mjedisore dhe shëndeti mendor, po bëhen pjesë e veprimit komunitar, si mekanizëm vet-rregullator e vet-mbrojtës i shoqërisë.

Polucionit mediatik i rrjeteve televizive që tashmë janë si copy-paste e njëra tjetrës, qoftë në informacion, ashtu dhe në program, po ndëshkohet nga ky common sens vet-rregullator. Aktualisht ka një shikëputje dhe një rënie drastike të interesit të audiencës, e cila refuzon heshturazi klisenë e ndjekjes një dimensionale të telekulturës.

Kërkesa komunitare, për një për identifikim dhe regjistrim të mediave on-line në zyrat e QKB, është një tjetër hap vet rregullator e vet-mbrojtës i komunitetit për të disiplinuar piraterinë.

Siç dihet, rreth 75 %, e pronësisë intelektuale, sot rezultojnë e vjedhur. Individuë anonimë nxjerrin fitime të konsiderueshme nga kjo pirateri dhe askush prej tyre nuk ndëshkohet, pikërisht dhe pse ato nuk figurojnë të regjistruar askund.

Personalisht kam bllokuar 28 web dhe you-tube, përdoruesish vepra arti. Jam ankimuar në platformat e tyre përkatëse për vjedhjet e kryera, por një akt i tillë do ish mirë të kryej dhe nga institucione të specializuara për këtë çështje.

Ne kemi zyra përkatëse shtetërore, që mbrojnë ligjërisht piraterinë, por ato ende nuk po sjellin frytet për të cilat janë krijuar.

Dhe së fundi, procesi i vettingut, mendoj se duhet shtrirë dhe tek pronarët e mediave, për të ndërprerë piraterinë e programeve, për të vendosur raportin e drejtë mes pronarit dhe pavarësisë së gazetarëve si dhe të për të nxitur më tej rolin e gazetarisë investigative si mbrojtëse direkte e interes publik në vendin tonë.

12.2 MEDIAT ONLINE NËN SULM: NISMAT LIGJORE DHE RETORIKA POLITIKE, NGA ZNJ. KRISTINA VOKO, DREJTORE EKZEKUTIVE BIRN (BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK)

Mediat në internet, të cilat shpesh referohen si portale lajmesh, janë bërë një peshë në rritje në tregun e medias në Shqipëri. Numri i medias online ka pësuar shpërthim përgjatë viteve të fundit; me qindra portale dhe agregatorë lajmesh të hapur. Sipas kreut të Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, një OJF me bazë në Tiranë, janë më shumë se 650 portale lajmesh të regjistruara më 2017, nga të cilat vetëm 72 drejtohen nga gazetarë. Për shkak të numrit të vogël të mediave dhe tregut të vogël, shumica e medias në internet, me pak përjashtime, nuk ka burime financiare dhe shumica dërrmuese e tyre ri publikon lajmet nga mediat kryesore komerciale të

lajmeve. Plagjarizmi ose i ashtuquajtur 'copy-paste', sensacionalizmi me tituj karrem dhe mungesa e standardeve profesionale janë disa nga problemet shpesh të lidhura me median në internet .

Sipas një vrotjimi të kryer nga IDRA , media në internet është një nga tre burimet kryesore të informacionit për 55% të popullsisë - duke u renditur e dyta pas stacioneve televizive dhe duke lënë pas shtypin e shkruar dhe radiot. Një ndikim të veçantë në rritjen e lexueshmërisë në internet përgjatë viteve të fundit ka pasur përhapja e smartfonëve dhe paketat më të lira të internetit të dhëna nga kompanitë e telekomunikacionit.

Me rritjen e peshës së mediave online, gjatë viteve të fundit janë vërejtur dhe një sërë tentativash për kontrollin e tyre nga ana e 'pushtetarëve', herë përmes nismave ligjore dhe herë përmes sulmeve verbale ndaj mediave dhe gazetarëve. Më poshtë përmbliidhen disa nga nismat kryesore ligjore dhe retorikës politike, të cilat në shumicën e rasteve kanë pasur për synim pikërisht median online.

Nismat ligjore mbi mediat online

Kuvendi i Shqipërisë dhe/ose Qeveria e Shqipërisë përgjatë katër viteve të fundit kanë ndërmarrë pesë nisma për ndryshime ligjore që synojnë që të gjitha vendosjen e një mase kontrolli mbi median në internet, kryesisht përmes tre mekanizmave: detyrimit për identifikim apo regjistrim në një autoritet publik; ngarkimit të përgjegjësisë administrative në lidhje me përmbajtjen e faqeve të internetit, qoftë kjo nga poseduesit e faqes, qoftë nga persona të tretë në rolin e përdoruesve të faqeve dhe; kërcënimit me mbyllje të faqeve informative të internetit në rast të mosrespektimit të kriterëve të mësipërme. Këto tre elementë që synojnë identifikim, gjëmbajtje dhe mbyllje të faqeve të internetit janë prezantuar si ndryshime në pesë ligje të ndryshme dhe kanë pasur për origjinë atë që autoriteti politik e sheh si 'bezdisje' në punën e vet.

1. Ndryshimi i parë i propozuar njihet në media si "Amendamenti Bregu". Ai u propozua nga ish-deputetja Majlinda Bregu në prill të vitit 2015 si një ndërhyrje në Kodin Civil. Ndërhyrja parashikonte "identifikimin" e personit përgjegjës për një portal, bllokimin nga ana e AKEP të aksesit në faqet që nuk plotësonin këtë kusht, përgjegjësinë civile të administratorit për një gamë të gjerë "shkeljesh" të përshkruara nga propozuesi si cënime mbi "nderin, personalitetin apo reputacionin" e një individi .

Të tria ndërhyrjet, pra identifikimi, bllokimi dhe përgjegjësia, niseshin nga ajo që propozuesja i quante "eksperiencia personale". Si të tilla, shqetësimet që synohej të trajtoheshin përmes ndryshimeve ligjore mund të ishin ose nuk mund të ishin shqetësime të përgjithshme të popullsisë. Ato synonin zëvendësimin e sistemit aktual të zgjidhjes së pakënaqësive përmes çështjeve gjyqësore me zgjidhje të karakterit administrativ. Megjithatë, ndërhyrjet e propozuara në këtë amendament nuk lidheshin me rregullimin e përmbajtjes së faqeve informative, pra informacionit të ofruar ndaj publikut, por vetëm me komentet e publikut mbi temat e trajtuara.

2. Në Nëntor 2015, qeveria shqiptare dërgoi në parlament në fshehtësi të plotë dhe pa asnjë proces konsultimi publik një nismë ligjore që parashikonte ndryshime në Kodin Penal dhe 'kriminalizimin e shpifjes'. Megjithatë, nisma nuk synonte të kriminalizonte çfarëdolloj shpifjeje, por vetëm atë lloj fjale, shkrimi apo deklarate që shënjestron drejtuesit e shtetit. Shpifja, sipas këtij propozimi ligjor, ishte vetëm ato "sjellje që manifestohen përkundrajt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhur, në rastin kur ndaj këtyre të fundit shpifet me qëllim dhe publikisht lidhur me fakte të cilat ligji i parashikon si vepra penale" . Propozimi synonte të dënonte atë që qeveria e quante "shpifje ndaj zyrtarëve të lartë" me gjobë deri në tri vjet burg. Qeveria pretendonte se kjo masë ishte e nevojshme për të ndaluar "abuzimet me lirinë e fjalës". Protestat dhe zemërimi publik i shkaktuar nga zbulimi i planit të qeverisë për të dënuar me tre vjet burg "shpifjen ndaj zyrtarëve të lartë" si "krim kundër shtetit" bënë që qeveria të deklarojë tërheqjen e projektligjit brenda më pak se 12 orësh nga publikimi i lajmit. Kryeministri Edi Rama, i cili qe sponsorizuesi i propozimit, kërkoi ndjesë në një postim në Facebook dhe u përpoq të sugjeronte se bëhej fjalë për një keqkuptim dhe se synimi i tij qe që të dënonte politikanët dhe jo gazetarët .
3. Afro një vit më vonë pasi "amendamenti Bregu" dështoi të kalojë në procedurë parlamentare si pasojë e debatit të gjerë publik, Ministria e Inovacionit propozoi disa ndryshime në Ligjin "Për Tregtinë Elektronike". Në këtë rast, faqet informative trajtoheshin ngushtësisht si subjekte të tregtisë elektronike dhe si të tillë, ngarkoheshin me përgjegjësi për "përmbajtje të paligjshme". Edhe këtu, faqet e internetit kishin një përkufizim të gjerë, duke përfshirë çdo gjë, nga faqet e mediave konvencionale në internet tek blogjet personale apo faqet e kompanive. Edhe këtu detyrimi kryesor ishte identifikimi i lehtë i faqeve përmes detyrimit të publikimit të adresës dhe personit përgjegjës. Ndërsa në botën e tregtisë elektronike është normale pasja e një dokumenti të kushteve të punës, adresës së kontaktit dhe detaje të tjera, përfshirja e botës së informacionit në kategorinë e "tregtisë elektronike" pavarësisht nëse ka marrëdhënie financiare mes poseduesit dhe përdoruesit dhe pavarësisht llojit të kësaj marrëdhënieje financiare, zgjerimi i kriterëve të tregtisë te bota e informacionit krijoi shqetësime për mundësinë e presionit mbi faqet e lajmeve. Në ndryshimet në nenin 17 të ligjit parashikohej përgjegjësi për faqen e internetit në rast se në serverin e tij gjendej "përmbajtje e paligjshme" dhe nuk e hiqte atë brenda 24 orësh nga "marrja e njoftimi". Edhe në këtë rast, gjykatat zëvendësoheshin me "institucion përgjegjës" dhe/ose "palë të prekura". Edhe në këtë rast, kërcënimi, përveç gjobës ishte "çaktivizimi i aksesit" për ofruesin e shërbimit, si dhe parashikohej krijimi i institucioneve kontrolluese, përfshirë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrin e Inovacionit. Gjopa për shkelje përcaktohej në këtë propozim në masën 200 mijë lekë . Projektligji nuk flet drejtpërsëdrejti për përmbajtjen e lajmeve apo të

- komenteve, por në një numër intervistash, Milena Harito, në atë kohë, ministre për Inovacionin, e bëri të qartë që synimi ishte “dënimi i komenteve online” .
4. Në dhjetor të vitit 2016, ndërsa “projektligji Harito” mbeti pa u dërguar për shqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë, kryetari i grupit parlamentar socialist Taulant Balla dorëzoi në Kuvendin e Shqipërisë propozime për ndryshime në Kodin Zgjedhor. “Propozimi Balla” përfshinte detyrimin e portaleve për regjistrim pranë një institucioni të quajtur Bordi i Monitorimit të Medias si dhe mbylljen e tyre në rast se angazhoheshin në atë që ligjvënësi i referohet si “propagandë elektorale”. Propozimi nuk u dërgua për shqyrtim në parlament.
 5. Në dhjetor 2018, Autoriteti i Medias Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare prezantuan ndryshimet e propozuara në dy ligjet organike të këtyre institucioneve. Në njoftimin e parë për shtyp të dërguar më 12 dhjetor, AMA i prezantoi projektligjet si të “propozuara prej Këshillit të Ministrave”. Njësoj si në frymën e nismave të mëparshme, projektligjet synojnë krijimin e një regjistri të medias online, detyrimin e faqeve të lajmeve të vetë identifikohen si dhe krijimin e një strukture të policimit të përmbajtjes së lajmeve, me një fushë të gjerë veprimi, me fuqi për të vendosur gjoba dhe për të mbyllur median online ose aksesin në të.

Abuzimi verbal ndaj mediave

Në shtator të vitit 2016, me nismë të disa deputetëve socialistë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshime në ligjin “Për Menaxhimi e Integruar të Mbetjeve”. Nisma parashikonte lejimin e importit të mbetjeve dhe u kritikua ashpër nga opinioni publik, ku kryeministrit iu rikujtua se premtimi i tij kryesor në zgjedhjet e vitit 2013 ishte pikërisht anulimi i importit të mbetjeve, i cili u lejua fillimisht nga qeveria PD+LSI në vitin 2011. Pas protestave popullore kundër ligjit të ndryshuar të Ramës dhe pasi aktivistë të llojeve të ndryshme vunë emrat e deputetëve më së shumti socialistë në kazanët e plehrave në të gjithë Shqipërinë, Rama e cilësoi median “kazan” , një epitete që vijoi ta përdorë herë pas here që nga ajo kohë. Një muaj më vonë, më 30 tetor 2016, Rama mbajti një fjalim në Facebook ku sulmoi “pjesa dërrmuese e mediave dhe analistëve, janë kthyer në një parti politike, e cila as votohet, as i jep llogari kujt” . Ai akuzoi median pa përmendur emër konkret se “financohen me gjoba të paligjshme”, se përbëhet nga “një rrjet veprimtarësh të paguar që prodhon tituj kriminalizues” apo se ka “raportime shantazhuese”.

Sulmet e Ramës ndaj medias, në veçanti asaj në internet, vijuan edhe përgjatë vitit 2017. Në qershor, gjatë një interviste në emisionin Zonë e Lirë në TV Klan, ai u pyet për një listë me gazetarë dhe iu përgjigj nëse janë apo jo kazanë.

Në tetor 2017, ndërsa maxhoranca socialiste hodhi poshtë kërkesën e prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit të brendshëm Saimir Tahiri, Rama sulmoi gazetarët në një konferencë të improvizuar për shtyp jashtë dyerve të Kuvendit të Shqipërisë . Krahas sulmeve të Ramës, gazetarët që po intervistonin Tahirin më 21 tetor 2017 u përballën me fyerje dhe sharje nga mbështetësit e tij .

Gjatë vitit 2018, përpjekjet e Ramës për të mbrojtur veten nga akuzat e

shumëfishta përmes sulmimit të medias shënuan një nivel të ri të lartë. Në tetor, në një seri mesazhesh në Twitter ai kërcënoi “portalet” të cilat ai i konsideroi të tilla që kishin nevojë për “legalizim” përmes regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kërcënimi i tij me një afat 72 orësh nuk u materializua, por pak ditë më vonë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare kërcënoi 44 faqe interneti me mbyllje duke supozuar se këto faqe nuk ishin të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe rrjedhimisht duke krijuar insinuatën se media online është evazore fiskale .

Njoftimi për shtyp i AKEP u kritikua në masë të gjerë. Përfaqësuesi i OSBE për lirinë e shprehjes Harlem Désir publikoi një deklaratë kritike ndërsa organizata Reporterë pa Kufi reagoi në Twitter duke e dënuar atë.

“RFS dënon një vendim të qeverisë shqiptare që detyron disa media online të regjistrohen në një institucion publik brenda tre ditësh ose në të kundërtën mbyllen,” shkroi RSF.

“Supozohet se kjo masë synon të godasë shpifjen online por kjo iniciativë nga kryeministri @ediramaal kërcënon lirinë e medias dhe faqet e pavarura të internetit të cilat shpesh ofrojnë raportim investigativ mbi korrupsionin dhe bashkëpunimin e qeverisë shqiptare me krimin e organizuar,” shtoi RFS.

Në dhjetor, qeveria propozoi ndryshime në dy ligje kyçe, ai i Komunikimeve Elektronike dhe ligji për Median Audiovizive, duke paralajmëruar krijimin e një regjistri të medias online, si dhe “përgjegjësi administrative” të medias në internet, përfshirë gjopa deri në 8 mijë euro dhe mbyllje të aksesit në territorin shqiptar.

Prezantuar si një nismë që synon “disiplinimin” e medias, të dy projektligjet u dënuan nga organizatat shqiptare dhe ndërkombëtare, të cilat i kërkuan qeverisë tërheqjen e tyre. Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se nuk ka ndër mend të tërhiqet.

Nëse miratohen këto ligje, Shqipëria do të bëhet një nga një grusht i vogël vendesh në botë që kanë ligje për “përmbajtje të paligjshme” në internet, dhe që kanë procedura administrative jashtëgjyqësore për gjobitjen dhe mbylljen e faqes të internetit.

12.3 MEDIA, JO VETËM MISION INFORMUES POR EDHE KULTUROR Z. DENIS DYRNJAJA, GAZETAR

Media, jo vetëm mision informues por edhe kulturor!

Pak histori

Bashkë me ardhjen e sistemit pluralist në Shqipëri lindi edhe pluralizmi mediatik. Me krijimin e partisë së parë opozitare, lindi edhe gazeta e parë opozitare që ishte një organ partiak. Duhej kaluar nga një sistem i centralizuar mendimi në

një sistem të hapur të përcjelljes së lajmit dhe opinionit. Indoktrinimi i sistemit që po linim pas i ngushtonte rrugët dhe hapësirat e mendimit, por liria që sapo ishte fituar presiononte për t'u hapur në këtë drejtim. Ndaj përpjekjet e para ishin shprehëdhënëse pasi u krijuan gazetaret e para jo partiake të cilat u shndërruan në burimet kryesore të informacionit dhe opinion bërjes. Në një fazë të mëvonshme, këtij ndryshimi iu nënshtrua radio fillimisht e më pas edhe televizioni e më pas media online që sot është e përhapur gjerësisht. Por ndërsa në shtypin e shkruar kishte traditë dhe kualitet gazetarësh dhe ishte vetëm thjesht çështje përshtatjeje, në radio dhe televizion gazetaria televizive po krijonte embrionet e saj nga e para, pasi tradita e Radio Televizionit Shqiptar ishte e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur teknologjisë së re dhe mënyrës së re të raportimit. Ndaj ndodhën disa konvertime që unë do t'i cilësoja të papërshtatshme. Gazetarët e Shtypit të Shkruar filluan të penetronin në median audio-vizive. Ata erdhën pa eksperiencë në këtë zhanër dhe krijuan një hibrid raportimi që e trashëgojmë edhe sot, ndryshe nga shkolla britanike, frankofone apo gjermanike e raportimit. Ishte një shartim mes shkollës klasike lindore dhe statike që kemi trashëguar në mendësi dhe asaj italiane që kishim fituar instinktivisht. Pra një hibrid improvizues jashtë standardeve klasike të raportimit. Gjuha e raportimit ishte shumë lineare, shpesh shumë e thjeshtë për të mos thënë e varfër, e tillë vijon me përjashtime të rralla. Për shkak të kulturës kemi trashëguar një gjuhë të dobët raportimi, shpesh të keq shkruar dhe keq folur.

Media si përçuese e kulturës

Media nuk është thjesht ngjarja e raportuar. Brenda saj ka elementë të kulturës që përfton publiku. Gjuha e përdorur dhe e shkruar në lajme, shërben në mënyrë direkte dhe indirekte në formimin e kulturës së përgjithshme të shoqërisë. Dhe pyetja është: a transmeton kulturë gjuha e folur sot në media? Përgjigjja është po, por një kulturë shpesh sipërfaqësore ose e cinguar. Në shumë raste përcjell vulgaritetet dhe mungesë informacioni dhe dijes. Pjesa më e madhe e armatës së gazetarëve që militojnë në media, kanë aftësi të kufizuara të komunikimit dhe cilësi të mangët në të shkruar dhe dije për fushat që mbulojnë. Parapërgatitja në shkollat e profilit është e dobët. Gazetaria shihet si një profesion që mund të bësh një punë dhe jo si një profesion elitare të cilin nuk mund ta bëjë kushdo që ka përpara një tastierë kompjuteri, një mikrofoni apo një kamerë. Për shkak të këtyre mangësive në kulturë, në produktet finale mediatike kemi shumë mediokritet, banalitetet dhe vulgaritetet në komunikim. Fenomeni është aq i përhapur sa është shndërruar në normalitet madje në standard. Një problem më vete është edhe etika, e cila është mjaft e çënueshme. Nuk arrihet të bëhet dallimi ku fillon dhe ku mbaron e lejueshmja, qoftë në lajmin e shkruar dhe të transmetuar. Media është shndërruar në frengji diskriminimi dhe shpifjesh, por në raste më ekstreme edhe në çënues të interesave të individëve apo biznesit, etj. Kjo mënyrë e të bërit gazetari, ka kompromentuar rëndë misionin e medias në tërësi dhe gazetarisë në veçanti. Gazetaria hulumtuese është e mangët dhe në shumë raste ose është selektive ose është sipërfaqësore. Ndaj shumë fenomene shoqërore dhe problematika ose mbeten të pa trajtuara ose të trajtuara keq.

Revolucion dhe katarsis mediatic

Po si do të dalim nga ky rreth vicioz ku vegjeton media prej vitesh në Shqipëri?! Së pari nevojitet krijimi i kultit të integritetit. Kulti i Integritetit duhet krijuar që në bankat e shkollës ku studentëve kandidatë për të qenë nesër gazetarë apo reporterë të medias, t'u injektohet shenjtëria e profesionit të gazetarit në raport me të vërtetën. Nuk ka dy të vërteta, por një dhe ajo nuk mund të jetë pjesë e kompromiseve për përfitim kapital ose jo. Duhet krijuar një raport i ri me të vërtetën dhe një raport i drejtpërdrejt me publikun. Publiku duhet të shohë dhe ndjejë se media reflekton dhe mbron interesat e tij dhe jo thjesht t'i përdorë ato për show sipërfaqësor ose konsum ditor. Është e nevojshme të krijohet një brez i ri gazetarësh kurajozë që do të ndërtonin e përfaqësonin edhe një media të re e kurajoze në interes të publikut. Establishmenti mediatic duhet tronditur sepse ai është kontributi kryesor i pështjellimit publik ose i përgjumjes së publikut. Një media aktive profesionale do të mbante gjithmonë aktiv opinionin publik për çështje në interesin e tij, do të krijonte një qeverisje më të përgjegjshme dhe një politikë në tërësi më të mirë. Media nuk është fajtori, por me mosveprimin ose me qasjen e saj të gabuar mund të shndërrohet në bashkëfajtorë në raport me të vërtetën, realitetin dhe interesat e publikut.

12.4 TË DREJTAT E GAZETARËVE NË PUNË, ZNJ. DAFINA HYSA, GAZETARE

Liria e shprehjes dhe e medias, janë të sanksionuara në Kushtetutën shqiptare, por ende sot, profesioni i gazetarit është i parregulluar dhe në një nivel të lartë informaliteti. Komuniteti mediatic, e ka vënë theksin në vazhdimësi tek vetë rregullimi i tregut, që ka mbetur sfidë e vazhdueshme. Të jesh gazetar që respekton parimet bazë të gazetarisë, po bëhet gjithnjë e më e vështirë në Shqipëri. Sot punonjësit e medias, përveçse në një situatë të pasigurtë ekonomike, përballen me kërcënime nga bota e krimit, por edhe fyerje e presione nga politika, e madje nga drejtuesit më të lartë të ekzekutivit. Censura dhe vetë censura por edhe pasiguria që kanë rreth 80% e gazetarëve për të ushtruar profesionin në të ardhmen, listohen ndër problemet kryesore edhe në raportin e fundit të "Reporterëve pa kufij". Vetë censurimi buron nga ndërhyrjet dhe qëndrimet editoriale të paracaktuara nga pronarët e mediave, pasja dijeni për lidhje dhe interesa të pronarëve me politikanë dhe grupe të caktuara, por edhe nga reklamat.

Nisur nga kjo situatë, a duhet hapur debate, për një rregullim të tregut, por pa çënuar lirinë editoriale dhe fuqizuar ndërhyrjen e shtetit? A mund të sillte përmirësim të situatës, statusi i gazetarit?

Të gjithë biem dakord për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e pasjes së një gazetarie të pavarur dhe profesionale. Por, a është e mundur sa kohë nuk sigurohen kushte të favorshme pune, autonomi profesionale dhe garanci financiare? Studimet si nga organizatat kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, paraqesin një panoramë të zymtë, të asaj çka ndodh me median në Shqipëri.

Në fakt pasiguria në tregun mediatik, ndonëse jo në këto nivele, ka nisur të ndihet fort prej të paktën një dekade. Jam pjesë e kësaj kategorie, që pasiguria për profesionin, më shtyu drejt studimeve të thelluara në fushën e drejtësisë.

Kontratat e punës, fiktive

Kontrata e punës, është një marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit që përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve, por që në fakt konsiderohet si garanci veçanërisht për punëmarrësin si pala më e dobët në një marrëdhënie të tillë. Megjithatë edhe pse 60% e gazetarëve pohojnë se kanë lidhur kontrata pune, gjatë karrierës së tyre, ato kanë qenë thuajse fiktive. Raporti i Komisionit Europian, të këtij viti evidenton problemin me mungesën e formalizimit të kontratave të punës nga pronarët e medias. Raporti thekson se siguria e punës për gazetarët duhet forcuar, përmes zbatimit në mënyrën e duhur të Kodit të Punës.

Në vendin tonë, në mungesë të një ligji specifik, për sektorë të ndryshëm, siç janë edhe gazetarët e punonjësit e medias, marrëdhëniet e tyre të punës, rregullohen përmes Kodit të Punës. Referuar këtij Kodi, kontrata e punës, është konsensuale dhe ka si element thelbësor vullnetin e lirë të palëve. Por ajo që ndodh në përgjithësi me punonjësit e medias, është firmosja e një kontrate standarde, të hartuar në mënyrë të njëanshme, nga punëdhënësi. Kjo bëhet sidomos për të përmbushur formalisht detyrimin e punëdhënësit përkundrejt kërkesave ligjore. Për shkak të specifikës që ka puna e gazetarit, shihet si nevojë, që përveç kritereve formale të një kontrate pune që parashikon kodi i punës, të vihet theksi tek autonomia e tij.

Po ashtu shihet me interes kontrata kolektive e punës, cila garanton një nivel më të lartë mbrojtjeje për punonjësin. Kontratat kolektive janë marrëveshje mes punëdhënësve ose organizatave që i përfaqësojnë dhe organizatave të punëmarrësve, që kanë në thelb përcaktimin e kushteve të punës. Rëndësia e kësaj kontrate, qëndron në faktin se të drejtat e përcaktuara aty, rrjedhimisht do të jenë më pas pjesë e kontratës individuale, që do të lidhë punëmarrësi me punëdhënësin. Por edhe sot, në asnjë prej mediave në Shqipëri, nuk funksionon kontrata kolektive e punës.

Informaliteti në tregun mediatik, 40 % e punonjësve të paregjistruar

Media është konsideruar ndër vite, si një nga sektorët me nivelet më të larta të informalitetit. Në vitet 2000 referuar publikimeve në shtyp, përlllogaritej se vetëm 10% e gazetarëve në Tiranë, ishin të siguar, rrjedhimisht 90% punonin në të zezë. Kjo situatë ka vijuar me luhatje të lehta, për të arritur në nivelin e 75% në vitin 2006. Në fund të vitit 2011, 65% e gazetarëve sipas UGSH rezultojnë të siguar, por 50% të regjistruar sipas pagës minimale. Kur pritej që tregu të formalizohej edhe më tej, në fakt ndodhi e kundërta. Në raportet vjetore të publikuara në vitet 2015 dhe 2016, nga Unioni I gazetarëve shqiptarë evidentohet se informaliteti në tregun mediatik ishte në 80%. Ky rezultat lidhet edhe me krijimin dhe hyrjen në treg të një numri të madh portalesh, me shumicën e punonjësve të deklaruar. Asokohe nga të dhënat e unionit ishin të punësuar në media (TV, radio, gazeta dhe portale), 2350 gazetarë

dhe rreth 5700 punonjës të tjerë. Fushata kundër informalitetit, e nisur në shtator të vitit 2015, statistikisht dha ndikim edhe në sektorin mediatik. Referuar UGSH, niveli i informalitetit ka zbritur në rreth 40%. Megjithatë nënshkrimi i kontratave është një proces thuajse formal, që nuk ka në thelb një trajtim dinjitoz duke respektuar të drejtat e gazetarëve, por si një masë për të mos rezultuar në shkelje ligjore, në rast kontrolli nga institucionet (për hir të së vërtetës, media është një sektor, që bën përjashtim).

Në pyetësorin e realizuar në 2018 nga Instituti i Medias, 67% e të anketuarve, pohuan se kanë nënshkruar një kontratë pune pa afat ose me afat 1-vjeçar; 28% ishin pa kontratë, ndërsa 5% refuzuan të përgjigjen. Gjithsesi duhet theksuar se kemi të bëjmë me të dhëna të një ankete ku u përfshinë 212 punonjës të medias, kryesisht redaktorë, kryeredaktorë dhe gazetarë.

Punësimi gri, penalizim për nënat gazetare

Si edhe në sektorë të tjerë, ku niveli i informalitetit është mjaft i lartë e përllogaritet në 40%, edhe media nuk bën përjashtim. Por me të vetmin ndryshim, se gazetarët raportojnë për punonjësit e sektorëve të tjerë në të zezë, por nuk arrijnë të ngrenë zërin për të drejtat e tyre të shkelura. Një pjesë tjetër e konsiderueshme është në kategorinë e punësimit gri, thënë ndryshe punonjës të regjistruar por jo me pagën reale. 54 % e të anketuarve në sondazhin e Institutit të medias, realizuar në vitin 2018, pohuan se nuk marrin pagën që deklarohet. Kjo metodë përdoret nga kompanitë, madje ka raste edhe pa i informuar punonjësit, veçanërisht ata që kanë negociuar pagën neto, ndërsa kompania ka marrë përsipër shlyerjen e detyrimeve të tjera. Për rrjedhojë punëdhënësit derdhin kuotë më të ulët të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, apo tatimit mbi të ardhurat personale. Një trajtim i tillë, përveçse evazion fiskal, është mbi të gjitha penalizim financiar, për punonjësit e medias, si në rastin e raporteve shëndetësore, paaftësive të përkohshme dhe të përhershme, barrë lindje, apo edhe në momentin kur mbushin moshën e daljes në pension.

Megjithatë ka mjaft raste kur punonjësit e medias, pranojnë punësimin gri, edhe kur jenë në dijeni të pasojave, pasi është një nga kushtet e vendosura nga punëdhënësi, në këmbim të fitimit apo mbajtjes së vendit të punës. Gazetarë dhe redaktorë, rezultojnë të deklaruar ende me pagën minimale, që sot është 24 mijë lekë në muaj. Shumë gazetarë, në momentin që kanë sjellë në jetë fëmijët, kanë përfitur një leje lindjeje në vlerë modeste, krahasuar me pagën reale që merrnin. Me ndryshimet e vitit 2015, në ligjin Nr.7703, Datë 1.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ka ndryshuar edhe përllogaritja e pensionit, që del nga mesatarja e kontributeve të të gjithë karrierës ndër vite.

REKOMANDIME

- Gjetja e instrumenteve dhe mekanizmave për të fuqizuar rolin e sindikatave dhe shtrirë lëvizjen sindikale në çdo media. Sot kolegët, nuk shprehen mbi problemet e punës edhe në rrjete sociale, sepse nuk janë të pakta rastet e penalizimit edhe nga një qëndrim i tillë. Edhe pse operojnë disa sindikata të gazetarëve, apo medias, lobimi i tyre për të drejtat e punonjësve është në nivele të ulëta, por pa diskutim do të përjashtoja Unionin e Gazetarëve, si i vetmi zë që në vazhdimësi evidenton dhe adreson tek institucionet, problemet e punonjësve të medias, që vijnë nga mosrespektimi i ligjeve.
- Nisja e diskutimeve dhe ndërmarrja e nismës për miratimin e statusit të gazetarit. Ka shtete si :Belgjika, Franca, Ukraina apo Turqia që e kanë të përcaktuar me ligj, se kush konsiderohet një gazetar profesionist. Në Gjermani, profesioni i gazetarëve rrjedh drejtpërdrejt nga neni 5 i Kushtetutës, i cili mbron lirinë e mendimit, shprehjes dhe shtypit dhe ndalon censurën. gazetarët në Gjermani nuk duhet t'i nënshtrohen procedurave formale apo të detyrueshme.
Profesioni është i hapur për të gjithë, pa asnjë nevojë për trajnim ose përzgjedhje. organizatat profesionale kanë qenë gjithmonë kundër një përkufizimi ligjor detyrues ose rregullator nga frika se parlamenti ose autoritetet politike në përgjithësi do të kufizonin liritë e tyre. Një shembull tjetër është Polonia, ku statusi i gazetarëve nuk është më i përcaktuar me ligj, siç ishte deri në vitet 1980.
- Nënshkrimi i kontratave kolektive të punës, garanton një nivel më të lartë mbrojtjeje për punonjës. Meqenëse deri tani, UGSH pavarësisht përpjekjeve nuk ia ka dalë të bindë, drejtues të mediave të nënshkruajnë kontrata kolektive, atëherë propozohet që trajtimi i kësaj çështjeje për gjetjen e një zgjidhjeje, të shkojë në nivele të tjera, deri në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
- Nisur nga niveli i lartë i informalitetit, po ashtu puna në kategorinë gri, është e domosdoshme, por mbi të gjitha detyrim në bazë të ligjit, ndërhyrja e institucioneve, si; Inspektoriati Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si edhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Forcimi i kontrolleve nga institucionet e linjës, do të ndryshonte këtë panoramë, duke ulur ndjeshëm informalitetin.
- Verifikim i imtësishëm, për të shmangur derdhjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për një pagë më të ulët, sesa ajo reale. Në të njëjtën kohë, të bëhet verifikim, për të evituar regjistrimin e gazetarit, në pozicionin e një punonjësi tjetër në media, që nuk kërkon kualifikim të veçantë, apo arsim të lartë. Janë evidentuar raste, kur deklarohen si punonjës të tjerë të medias.

12.5 A MUND TË KONTROLLOHET MEDIA (VETËM) NGA LIGJI?

- ZNJ. KAROLINA RISTO, GAZETARE

(Rregullim apo vetë rregullim të medias)

Kontrolli mbi media është kontroll mbi mendimin e një grupi të madh njerëzish të cilët më pas mund ti përdorësh në funksion të qëllimit tënd.

Të parët që përpiqen të kenë sa më shumë kontroll mbi median (masmedian / mendimin e masës) janë natyrisht politikanët, dhe ata që kanë më shumë akses ndaj këtij qëllimi janë politikanët që kanë pushtetin.

Një pyetje retorike: A preferojnë qeveritë një media të lirë e të pavarur apo të kontrolluar?

Edhe në rasti e një politikani krejtësisht të dliër dhe idealist, pra që beson në ato që thotë 100 %, ky politikani (që vërshtirë se ekziston) do të dëshironte që kauzën e tij kaq të pastër ta besonin/ mbështesnin sa më shumë njerëz. Dhe ato media që nuk ia përçojnë ashtu siç do ai janë automatikisht “në kampin tjetër”, pra në grupin e atyre që janë renditur në kahun e gabuar të historisë (shprehja e preferuar e Barak OBamës gjatë kohës që ishte president i SHBA-ve.

Dhe kush nis këtë lojë e kontrollit ndaj medias i ka të qarta disa mënyra për të arritur qëllimin:

- Media kontrollohet duke financuar fuqizuar / kontrolluar direkt mediat shtetërore (E këtu nuk është vetëm fjala për RTSH në Shqipëri por edhe ushtria e mirë organizuar në batalione e zyrave të shtypit që hedhin pafund materiale për konsum)
- Mënyra e dytë është duke ndërhyre te mediat private. Dihet që këto media mbijetojnë përmes reklamës e “financimeve”. Reklama dhe financimet ose që vijnë direkt nga shteti, ose i shkojnë pronarëve në forma (biznese) të tjera dhe ndikojnë indirekt në politikën e tyre editoriale (ka bërë instituti i medias shumë studime për lidhjet e pronarëve të mediave kryesore në vend me politikën)
- E mënyra e tretë është social media, e pranuar zyrtarisht jo vetëm si media por që po fiton terren fuqishëm në % të informimit të publikut ndaj të gjitha platformave të tjera. Social media vërshtirë të kontrollohet, por në Shqipëri është gjetur zgjidhja që ka funksionuar prej vitesh edhe në sektorë të tjerë: diversioni. Nëse ka një media online që ka popullaritet (por me opinione që nuk i pëlqejnë atij politikani që preferon të kontrollojë opinionin publik) atëherë hapim 10 të tjera (me këto financimet e dyshimta) që kanë faqesje të ngjashme po brendi të ndryshme. Nëse ka një faqe në Facebook që ka efekt, veprojmë njësoj. Nëse ka një portal që ka shumë komentues (kryesisht kritikë) atëherë fusim në punë ushtrinë e PR (zyrat e nëndheshme të shtypit) për të ndryshuar raportin mes komenteve negative dhe atyre pozitive.

Dhe me këtë ritëm e këto metoda media është kthyer në një rrjetë merimange,

me ngjyra të ndryshme ku është pothuajse e pamundur të ndjekësh një fijen me ngjyrën që ke përzgjedhur nga fillimi deri në fund si ato lojërat labirint.

“Loja” e lobimit me publikun

Kurthi më i shpeshtë në të cilin bie publiku është ai i lobimit të qëllimtë. Njerëzit përmes mediave private, të mbështetura me biznese private sensibilizohen për kauza në dukje të drejta, që i shërbejnë qëllimit të tyre. Dhe vetëm kur sensibilizimi arrin kulmin, e ka mbështetje të gjerë pasohet në nismë ligjore ose formë tjetër reagimi që në fund, sjell përfitime vetëm për ata që frymëzuan në prapaskenë në heshtje këtë sensibilizim. Ne jemi të gjithë dëshmitarë të fushatave të gjera në media të caktuara p.sh.:

- Kundër mbeturinave në rrugë
- Kundër djegies së mbeturinave se shkakton ndotje
- Pro riciklimit të mbeturinave

Dhe pas brujtjes së opinionit publik me ndërgjegjen qytetare se duhen marrë patjetër masa - se fundja kush nuk është dakord që të ketë më plehra, apo që ato nuk duhen djegur - vjen kërkesa për ngritjen e ndonjë inceneratori, që natyrisht është iniciativë private. Kjo sa për të ilustruar me një shembull lojën e lobimit me publikun.

Kaosi online

Përshkrimi i mësipërm ishte për të treguar se situata e medias, si asaj të regjistruar, pranuar certifikuar, miratuar dhe licensuar është njësoj problematike si ajo e mediave online. Këto të fundit janë akoma më shumë kaotike por çfarë shërbimi do të sillte p.sh. regjistrimi i një portali.

Nëse unë hap sot ahc.org.al më del faqja e Komitetit të Helsinkit. Por nëse dua mund të hap një faqe identike jo me domain në Shqipëri, pra jo .al por .com. Të njëjtën faqe mund ta hap që sot, pa lëvizur nga kompjuteri edhe në Kinë, SHBA, Gjermani etj. Çfarë shpëton kjo në situatën e medias dhe sidomos në kaosin e medias online regjistrimi i një faqe. Nuk ka asnjë arsye për të qenë kundër formalizimit të një nisme private, por nëse ka një nismë të shoqërohet me të gjitha hapat që të mos ketë dyshime, akuza, hamendësime se në fakt është vetëm një mjet me shumë presioni ndaj këtyre portaleve.

E imagjinoni dot që për të njëjtën shkelje një portal, si p.sh. ahc.org.al gjobitet deri në 1 milionë lekë të reja, nëse hyjnë në fuqi ndryshimet dhe shtesat e propozuara në ligjin “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Pra me pak fjalë nëse një portal ose blog .al që mund të ketë të punësuar gjithsej 5 persona nuk hap një dritare dedikuar ankesave dhe nuk i jep përgjigjen dhe hapësirën në kohën e përcaktuar me ligj një personi që ankohet atëherë rrezikon të gjobitet nga AMA me 1 milionë lekë.

Me të njëjtin ligj, një televizion kombëtar ose Televizioni publik shqiptar rrezikon gjithashtu të gjobitet por me një gjobë 400 mijë lekë, pra 60 % më të vogël.

Në rregull por nëse një person ndjen se ndaj tij është publikuar një shpifje a nuk mjafton neni 120 i Kodit Penal që parashikon gjobë deri në burgim për rastet e shpifjes?

Një portal me një gjobë 1 milionë lekë, është i falimentuar.

Një televizion mund të mbijetojë me 400 mijë lekë gjobë, edhe pse po të shihet lista e mediave të gjobitura nga AMA, të fundit online janë ndaj televizioneve të vogla kabllore. Mediat e mëdha prej muajsh, vitesh, madje ndonjëra kurrë nuk ka bërë asnjë shkelje as etike, as shpifje, as fake news, as nuditet në ekran, as gjuhë të papërshtatshme, as përdorim të fëmijëve në mënyrë të papërshtatshme etj. etj.

Për të shkuar akoma më tej propozimet mbi ndryshimet në ligj parashikojnë edhe që nëse një portal merr nga ama 5 masa administrative, atëherë AKEP mund ta pezullojë portalin për 1 vit nga interneti. A duken ndëshkime ligjore paksa drastike jo shumë në proporcion me realitetin.

Ky është një argument por ana tjetër ndoshta edhe më e rëndësishme është: këto ndryshime ligjore, qofshin edhe drastike nga kush/çfarë/si/ e mbrojnë publikun?

E mbrojnë nga fake news?

- Ka sot ndonjë media që ka imunitet nga fake news pavarësisht nga forma ligjore si është regjistruar apo përmbajtja që ka?

E mbron nga shpifjet?

- Ne kemi një ligj mbi shpifjet, që parashikon jo vetëm gjobë por edhe burg në raste të rënda.

Mbron të drejtën e autorit?

- Sot ka shumë organizata që mbrojnë të drejtën e autorit në Shqipëri, të cilat autorizojnë mediat mbi bazën e disa formulave komplekse të miratuara nga Ministria e Kulturës, Ministria e Financave etj. etj.

Shembull 1 : Nëse jeni përdorues i veprave artistike, muzikore apo kinematografike duhet të drejtohesh drejt Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtave të Autorit (SUADA) për tu pajisur me lehtë/autorizimin përkatës për përdorimin e veprave.

Shembull 2: AKDIE, pretendon se është Agjencia e vetme e licensuar, për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues në Shqipëri, me e licensuar për herë të parë në vitin 2008 dhe me licencë të rinovuar në mënyrë të vazhdueshme çdo tre vjet, kur është afati i vlefshmërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Të dy këto agjenci në konflikte e gjyq me njëra tjetrën, por deri sa të zgjidhet gjyqi, mediat janë të detyruara ti paguajnë të dyja sepse të dyja janë licensuar nga Ministria e Kulturës të faturojnë mediat mbi bazën e metodologjisë së vendosjes së vlerës tarifore për të drejtën e artistit.

A kanë nevojë mediat për një tjetër ligj që të kontrollohet korrektesa e tyre?

Disa shtete e kanë zgjidhur (aq sa kanë mundur) me forma të tjera organizimi

- Sindikata
- Union gazetarësh
- Urdhër gazetarësh

Në fakt forma të tilla organizimi janë tentuar edhe në Shqipëri prej vitesh. Ne aktualisht kemi:

- (i). Unionin e Gazetarëve Shqiptarë, me drejtues Aleksandër Çipën
- (ii). Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë me drejtues Armand Shkullaku
- (iii). Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë me drejtues Ylli Rakipi.
- (iv). Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare me drejtues Aleksandër Frangaj
- (v). E një listë akoma më të gjatë organizatash jo fitimprurëse mediatike.

Asnjë nga këto tentativa nuk ka arritur të kthehet në autoritetin përfaqësues dhe aq më pak rregullator të gazetarëve. Ka raste sporadike kur ato kanë dalë në mbrojtje të ndonjë gazetari të dhunuar apo sulmuar publikisht, por edhe këtë nuk e kanë bërë në asnjë rast të gjitha organizatat së bashku.

Dhe asnjëra prej tyre as që ka tentuar të kthehet në organizmin ku fare thjeshtë:

- (i). Gazetarët të regjistrohen për t'u njohur si të tillë
- (ii). Ti marrë në mbrojtje kur iu shkelen të drejtat:

Kjo nuk është e pamundur. Për të marrë një shembull “nëse Urdhri i Gazetarëve në Itali vendos të dënojë një medie, mund ta gjobisë, mund të mos i akreditojë asnjë gazetar për një periudhë të caktuar, mund të mos e mbrojë

Një shembull që vlen të përmendet si formë organizimi është ajo e Urdhrit të gazetarëve në Itali. Në këtë shtet ka sot mbi 100 mijë gazetarë pjesë e Urdhrit të Gazetarit.

Ky është institucioni kryesor që rregullon funksionimin e gazetarëve në Itali edhe pse atje ligji mbi profesionin e gazetarit është në fuqi që prej vitit 1963. Ky ligj nuk ka pasur nevojë për ndërhyrje, pasi shumë dekada më parë përcaktonte profesionin e gazetarit si një aktivitet intelektual, që nuk e trajton gazetarin si nëpunës apo si punëtor por i njeht atij rolin thelbësor që ka në jetën sociale të vendit.

Në Itali, Europë por dhe në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara ligjet e medias kufizohen në përkufizime të përgjithshme mbi profesionin, lirinë dhe të drejtat e gazetarëve por në thelb kanë tendencën që t’ia lenë vetë në dorë atyre mënyrën e zgjedhur për të vendosur rregullat e brendshme.

Pak shtete demokratike kanë marrë guximin të vendosin kufi në autonominë e informacionit, duke e lënë këtë në dorën e organizmave si Urdhri, Sindikata ose Shoqëri.

Urdhri i gazetarit ka disa rregulla që i pranon kushdo që bëhet pjesë. Në shembullin italian rregullat janë:

- Pa u akredituar nga Urdhri nuk fiton dot statusin e gazetarit profesionist
- Që të akreditoresh nevojiten domosdoshmërisht 2 vite praktikë në një prej mediave të njohura nga Urdhri

Por po aq të rëndësishme janë dhe masat disiplinore që merren ndaj vetë gazetarëve ose redaksive në rastet kur anëtarët e akredituar shpallen fajtorë për “veprime që çenojnë dinjitetin profesional”.

- Ata mund të marrin paralajmërim
- Të pezullohen nga 2 muaj deri në 1 vit nga detyra

E fund natyrisht:

- Urdhri ka për detyrë të kujdeset që të respektohen të drejtat e të nënshkruarve Ky është vetëm shembulli italian. Shtete të tjera kanë gjetur zgjidhje të tjera, por fjala kyç e këtyre zgjidhjeve është : vetë rregullim.

12.6 A LIDHET LIRIA E SHPREHJES ME SHKELJET E KODIT TË ETIKËS?

- Z. KOLORETO CUKALI, GAZETAR

Këshilli Shqiptar i mediave ka bërë një monitorim disa mujor të 20 portaleve online për të nxjerrë të dhëna statistikore mbi shkeljet e kodit të Etikës. Për periudhën 1 shtator – 15 dhjetor u evidentuan në këto 20 media 957 shkelje të Kodit të Etikës, **mesatarisht 9 shkelje në DITË.**

Shkeljet e Kodit të Etikës ndodhin për 2 arsye kryesore:

1. të paqëllimta (nga neglizhenca / injoranca / papërgjegjshmëria editoriale / kushtet e vështira të punës)
2. të qëllimta (interesa politike e ekonomike të botuesve për të deformuar lajmin)

Shkeljet e qëllimta të kodit të Etikës përbëjnë 45% të shkeljeve. Ky studim nxori edhe një pasqyrë të Neneve Kryesore të Shkelura të Kodit të Etikës:

1. Raportimi jo etik i procedurave gjyqësore dhe i pafajësisë 49.0%
Media konsideron kriminelë njerëz të padënuar nga gjykata ose raporton rastet duke shkelur etikën.
2. Saktësia e Informacionit 30.1%
Informacioni që jepet është i pasaktë, me ose paqëllim.
3. Dallimi i Faktit nga Opinioni 7.2% Në shumicën e rasteve, kjo shkelje është e qëllimtë.
4. Pavarësia Editoriale 7.7%
Siç shihet, shtypi është i lirë por, abuzimet janë të mëdha.
Ka 2 mënyra për ta zgjidhur:

Me Rregullim nga Qeveria

Ose

Me Vetë rregullim

RREGULLIMI nga QEVERIA

Rregullimi nga qeveria vjen përmes paketës anti-shpifje. PAKETA e ashtuquajtur “anti-shpifje” përbëhet nga 2 projektligje:

Proj-Ligji 1: “Për mediat Audiovizive dhe elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Proj-Ligji 2: “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Projekt-Ligji 1 (i AMA-s)

Disa nga nenet më problematike të këtij projektligji janë:

Neni 9 (Procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave)

4. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik, **brenda 24 orësh** nga marrja e ankesës, duhet të shqyrtojë ankesën dhe informojë ankuesin.

5. Nëse OSHPE-ja refuzon ankesën, ose nuk kthen përgjigje brenda 24 orësh nga marrja e saj, personi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit të Ankesave. Këshilli i Ankesave, **brenda 72 orësh** nga depozitimi /paraqitja e ankesës, vendos mbi ankesën përkatëse ose nga paraqitja e pretendimeve të OSHPE në rastet e zbatimit të pikës 6 të këtij neni.

6. Këshilli i Ankesave, **kur e çmon të nevojshme**, ia kalon ankesën e paraqitur OSHPE-së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 48 orësh.

7. Pas shqyrtimit të ankesës dhe/ose pretendimeve të OSHPE-së, Këshilli i Ankesave, **nëse çmon se ka shkelje, merr masat përkatëse**, duke përfshirë sanksionet në përputhje me këtë ligj.

Neni 11 (sanksionet)

1. Për OSHPE-të e regjistruara në AKEP:

a) Pezullim/bllokim të aksesit ne internet, **për një afat 24 orë**, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer 3 (tre) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj;

Pezullim/bllokim të aksesit në internet për një **afat 7 (shtatë)-ditor**, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se katër kundërvajtje administrative;

Pezullim/bllokim të aksesit në internet **për një afat njëvjeçar**, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se 5 (pesë) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj.

2. Për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike që nuk janë të regjistruara në AKEP:

Bllokimin e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik ne territorin e Republikës së Shqipërisë, **për një afat 24 orësh**, nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se tre herë gjatë një viti kalendarik;

Bllokimin përfundimtar/mbylljen e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e

përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se katër herë gjatë një viti kalendarik.”.

Problemet:

1. Eliminohet Gjykata nga vendimmarrja për sanksionet. Vendimi merret në mënyrë të menjëhershme nga Këshilli i Ankesave i AMA-s.
2. Koha 24 orë për përgjigje që kërkohet, është shumë e shkurtër.
3. Ky projektligj rregullon vetëm portalet, jo median print.
4. Nuk ka garanci nga Këshilli i Ankesave i AMA-s që do kryejë gjykime të pavarura e të pa-anshme, duke qenë ky vetë një institucion Bordi i të cilit zgjidhet nga politika.
5. Për të njëjtën shkelje ka sanksion dhe civil, edhe administrativ! Sanksionet administrativë ndaj portaleve, më të rënda se ndaj atyre mediave audio-vizive. Në përgjithësi sanksionet janë shumë të rënda.
6. BE ka zgjedhur vetë rregullimin si metodën e vetme të krijimit të një mediaje etike.

Vetë rregullimi

Vetë rregullimi është një proces ku mediat mblidhen dhe vendosin vetë si ta rregullojnë zbatimin e Kodit të Etikës.

1. Mediat organizohen në një organizatë të pavarur nga shteti (p.sh. KSHM).
2. Anëtarët (mediat) zgjedhin në mënyrë demokratike Bordin e Ankesave.
3. Bordi, është i pavarur, me integritet.
4. Bordi trajton ankesat që vijnë në kshm.al ose në website-n e Këshillit.
5. Bordi mblidhet në mënyrë periodike dhe merr vendime për zgjidhjen e konfliktit.
6. Vendimet e Bordit zbatohen nga mediat (p.sh. korrektimi, etj.)
7. Pas vendimit të Bordit, mund të shkohet në gjykatë.